Bazuar në nenin 36, paragrafi (1), pika 1, dhe në lidhje me nenin 25 paragrafi (1) të Ligjit të Kulturës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 265/24 dhe 132/25), Këshilli Drejtues i Institucionit Kombëtar "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" — Shkup, në mbledhjen e mbajtur në vitin 2025, miratoi

а на 11.04.2025 година, го

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
НАЦИОНАЛНА УСТАНОВА
ка на Република Северна
INSTITUTI NACIONAL
ORKESTRA E XHAZ MUZIKËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Бр.-Nr. 01-527/2
21.08 2025 год.-vjet
СКОПЈЕ - SHKUP

STATUT të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" — Shkup

1. Dispozitat e Përgjithshme

Rregullimi i lëndës

Neni 1

(1) Me këtë statut rregullohen emërtimi, selia, pozita juridike, përfaqësimi, veprimtaria, objekti i punës, organizimi, organet dhe fushëveprimi i tyre, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e organeve, procedura për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit, financimi, informimi dhe sigurimi i transparencës në punë si dhe çështje të tjera të përcaktuara me Ligjin e Kulturës dhe me ligje të tjera, të cilat janë me rëndësi për funksionimin e Institucionit Kombëtar "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" — Shkup (në tekstin e mëtejmë: Orkestra e Muzikës Xhaz).

(2) Ministri i Kulturës dhe i Turizmit jep pëlqimin për statutin nga paragrafi (1) i këtij neni.

Emërtimi dhe selia

Neni 2

(1) Emri i plotë i Orkestrës së Muzikës Xhaz është: "Republika e Maqedonisë së Veriut, Institucioni Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut' — Shkup, Република Северна Македонија, Национална установа „Оркестар за џез музика на Република Северна Македонија" — Скопје, Republic of North Macedonia, National Institution 'Orchestra for Jazz Music in the Republic of North Macedonia — Skopje."

(2) Emri i shkurtuar i Orkestrës së Muzikës Xhaz është: IN "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" — Shkup, „НУ „Оркестар за џез музика на

Република Северна Македонија” — Скопје, “National Institution “Orchestra for Jazz Music in the Republic of North Macedonia — Skopje””.

(3) Selia e Orkestrës së Muzikës Xhaz ndodhet në bul. “Goce Dellçev” nr. 4, në Shkup.

Themeluesi dhe sukcesioni

Neni 3

Themeluesi i Orkestrës së Muzikës Xhaz është Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me Vendimin për themelimin e Institucionit Nacional “Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut” — Shkup nr. 41-3061/3, të datës 21 mars 2023 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 68/23 dhe 82/23).

Pozita juridike

Neni 4

(1) Orkestra e Muzikës Xhaz është institucion nacional jofitimprurës nga fusha e kulturës, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj, kontratë kolektive, këtë statut dhe akte të tjera të brendshme.

(2) Orkestra e Muzikës Xhaz ka statusin e personit juridik, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Në qarkullimin juridik me palë të treta, Orkestra e Muzikës Xhaz vepron në emër të vet dhe për llogari të vet, ndërsa për detyrimet e veta përgjigjet me mjetet me të cilat disponon dhe për tërë shumën e detyrimeve.

(4) Orkestra e Muzikës Xhaz mund të kryejë ndryshime statusore (bashkim, përthithje, ndarje dhe/ose veçim) vetëm me vendim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vula dhe vula katrore

Neni 5

(1) Në veprimtarinë e vet Orkestra e Muzikës Xhaz përdor vulë dhe vulë katrore.

(2) Vula ka formë rrethore, me diametër 40 mm, në brendësi të së cilës, në mënyrë gjysmë-rrethore, me alfabet cirilik/latin është i shkruar teksti: „РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, НАЦИОНАЛНА УСТАНОВА „ОРКЕСТАР ЗА ЏЕЗ МУЗИКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА” - СКОПЈЕ, REPUBLIKES SË MAQEDONlSË, lNSTITUTl KOMBËTAR ORKESTRA E MUZlKËS XHAZ E REPUBLlKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - SHKUP, në pjesën e poshtme të vulës

figuron fjala “СКОПЈЕБНКИР”, ndërsa në qendër gjendet stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3) Vula katrore është drejtkëndëshe, me përmasa: gjatësi 65 mm dhe gjerësi 40 mm. Mbi tekstin e shkruar figuron stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa me tekst të shkruar në alfabet cirilik/latin, poshtë stemës gjendet teksti që thotë: “РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT”, nën të cilin, me shkronja të mëdha, vijon teksti: “ОРКЕСТАР ЗА ЏЕЗ МУЗИКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА” Скопје, “ORKESTRA E MUZIKËS XHAZ E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT — Shkup”, Në skajin e poshtëm gjendet një vijë për shënimin e datës; nën të figuron fjala “СКОПЈЕБНЮЈР”.

(4) Vula dhe vula katrore nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni ruhen dhe përdoren nga personi i autorizuar, i ngarkuar për kryerjen e punëve në zyrë, me aktvendim të drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(5) Personi nga paragrafi (4) i këtij neni dhe drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz janë përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e rregullt të vulës dhe vulës katrore nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

(6) Mënyra e përdorimit, ruajtjes dhe administrimit të vulës dhe vulës katrore nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni përcaktohet me akt të brendshëm, i cili me propozim të drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz, miratohet nga Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz.

Përfaqësimi dhe paraqitja

Neni 6

(1) Në qarkullimin juridik me palë të treta, Orkestra e Muzikës Xhaz përfaqësohet dhe përfaqëson pa kufizime drejtori.

(2) Një person tjetër mund ta përfaqësojë dhe ta paraqesë Orkestrën e Muzikës Xhaz vetëm mbi bazën e një autorizimi me shkrim (prokurë), i cili është dhënë nga drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, përfaqësuesi me prokurë e përfaqëson dhe e paraqet Orkestrën e Muzikës Xhaz brenda kufijve të autorizimit të dhënë.

Nënshkruesit e autorizuar të llogarive

Neni 7

(1) Orkestra e Muzikës Xhaz ka një llogari buxhetore për njësinë — përdoruese të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Nënshkrues i autorizuar i llogarisë buxhetore të Orkestrës së Muzikës Xhaz është drejtori, pa kufizime.

(3) Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz mund, me vendim, të caktojë edhe një nënshkrues të dytë ose disa nënshkrues të tjerë të xhiro llogarive, përkatësisht të nënllogarive të thesarit të Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz, me të njëjtën vendim, përcakton mënyrën e nënshkrimit dhe kufizimet eventuale të shumave deri në të cilat këta nënshkrues mund të nënshkruajnë.

VEPRIMTARIA DHE ORGANIZIMI

Veprimtaria themelore

Neni 8

(1) Veprimtaria themelore e Orkestrës së Muzikës Xhaz është "Arti interpretues" (shifra: 90.200).

(2) Veprimtaria nga paragrafi (1) i këtij neni është me interes kombëtar.

(3) Në pajtim me Ligjin e Kulturës, Orkestra e Muzikës Xhaz kryen këto veprimtari:

- Përgatitja dhe interpretimi publik i muzikës vokale dhe instrumentale të xhazit;
- Përgatitja dhe realizimi skenik i koncerteve të xhazit dhe i shfaqjeve të tjera muzikore brenda dhe jashtë vendit;
- Vendosja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar me muzikantë dhe orkestra nga fusha e muzikës xhaz, me qëllim rritjen e promovimit të muzikës xhaz në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Kryen edhe veprimtari të tjera në pajtim me ligjin dhe këtë statut.

(3) Ndryshimet në veprimtarinë e Orkestrës së Muzikës Xhaz mund të bëhen vetëm me pëlqimin paraprak të THEMELUESIT, përkatësisht të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Veprimtari shtesë

Neni 9

Përveç veprimtarisë themelore, Orkestra e Muzikës Xhaz kryen edhe këto veprimtari shtesë:

1. Botimi i librave (shifra: 58.110);
2. Krijimtaria letrare dhe muzikore (shifra: 90.110);
3. Artet interpretative (shifra: 90.200);
4. Veprimtari ndihmëse të tjera në krijimtarinë artistike dhe artet interpretative (shifra: 90.390);
5. Krijimtari artistike tjetër (shifra: 90.130);
6. Riprodhimi i mediave të incizuara (shifra: 18.200);
7. Botimi i revistave dhe publikimeve periodike (shifra: 58.130);
8. Veprimtari botuese të tjera (shifra: 58.190);
9. Funksionimi i objekteve për ngjarje artistike (shifra: 90.310);
10. Veprimtari për incizimin e regjistrimeve zanore dhe botimin e regjistrimeve zanore (shifra: 59.200).

Organizimi

Neni 10

(1) Funksionimi i Orkestrës së Muzikës Xhaz organizohet nëpërmjet njësive organizative dhe vendeve të punës në përbërjen e tyre, të cilat përcaktohen më hollësisht me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Orkestrën e Muzikës Xhaz.

(2) Me rregulloret nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen vëllimi, organizimi dhe natyra e detyrave të punës në njësitë organizative, si dhe numri i nevojshëm i ekzekutuesve për realizimin e tyre.

(3) Kryerja e punëve të të punësuarve si ofrues të shërbimeve/mbajtës të veprimtarisë në Orkestrën e Muzikës Xhaz rregullohet në pajtim me Ligjin e Kulturës dhe ligjin përkatës për veprimtarinë, ndërsa kryerja e punëve juridike, kontabël-financiare, administrative-profesionale dhe të tjera organizohet në njësitë organizative në pajtim me dispozitat për nëpunësit administrativë, dispozitat për të punësuarit në sektorin publik, dispozitat për marrëdhëniet e punës dhe dispozitat nga fusha e kulturës.

ORGANET E DREJTIMIT DHE MENAXHIMIT

Organi i drejtimit

Drejtori

Neni 11

(1) Organ i drejtimit i Orkestrës së Muzikës Xhaz është drejtori.

(2) Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz kryen këto punë:

- E udhëheq punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz,
- E përfaqëson Orkestrën e Muzikës Xhaz dhe është përgjegjës për veprimtarinë materiale-financiare si dhe për ligjshmërinë dhe ekonominë e punës së saj;
- Miraton programin vjetor të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz, me pëlqimin paraprak të Këshillit drejtues;
- I zbaton vendimet e Këshillit drejtues;
- E organizon realizimin e programit vjetor të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz;
- Miraton aktet për sistematizimin e vendeve të punës dhe për organizimin e brendshëm;
- Miraton aktet në lidhje me marrëdhënien e punës së të punësuarve, në pajtim me ligjin;
- Formon Këshillin artistik, përkatësisht Këshillin profesional dhe organe të tjera këshilluese (të përhershme dhe të përkohshme), në pajtim me këtë statut;

- Lidh kontratë me të cilën angazhon një person të jashtëm si këshilltar artistik, në pajtim me ligjin, brenda mjeteve të miratuara për punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz;
- Dorëzon raport çdo gjashtë muaj te ministri i Kulturës dhe i Turizmit për veprimtarinë financiare të Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe raport për realizimin e programit vjetor të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz, në pajtim me Ligjin e Kulturës;
- Dorëzon raport në tremujorin e parë të vitit aktual për vitin e kaluar tek Ministria e Kulturës dhe e Turizmit për realizimin e PROGRAMIT VJETOR të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz, në pajtim me Ligjin e Kulturës;
- Miraton planin VJETOR të punësimit për vitin e ardhshëm, pas mendimit paraprak të Ministrisë së Administratës Publike dhe pëlqimit paraprak të Ministrisë së Kulturës dhe të Turizmit;
- Formon komisione për zhvillimin e procedurave disiplinore për parregullsi disiplinore ose shkelje disiplinore;
- Miraton aktvendime për masa disiplinore në pajtim me ligjin;
- Miraton udhëtime zyrtare brenda vendit dhe jashtë tij për të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz;
- Drejton organizimin dhe zbatimin e përgatitjeve për mbrojtjen;
- Kujdeset për informimin e saktë dhe të përkohshëm të të punësuarve dhe publikut,
- Miraton vendime dhe akte të tjera individuale në përputhje me ligjin;
- Siguron kushte për qasje të papenguar dhe ushtrimin e mbikëqyrjes administrative e inspektuese, revizione dhe llojeve të tjera të kontrollit të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz nga organet kompetente, dhe
- Kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin dhe këtë statut.

Neni 12

(1) Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz zgjidhet nëpërmjet shpalljes publike, e cila publikohet nëpërmjet mjeteve të informimit publik.

(2) Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz zgjidhet për një periudhë katërvjeçare dhe mund të zgjidhet përsëri.

(3) Konkursin publik për drejtorin e shpall Ministria e Kulturës dhe e Turizmit, në përputhje me kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin e Kulturës dhe kushtet e veçanta të përcaktuara me këtë statut..

(4) Ministri i Kulturës dhe i Turizmit e zgjedh dhe e shkarkon drejtorin e Orkestrës së Muzikës Xhaz, jo më vonë se tre muaj para përfundimit të mandatit të drejtorit të mëparshëm.

(5) Drejtori që është zgjedhur nga radhët e të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz, pas përfundimit të mandatit ose në rast të ndërprerjes së mandatit, sistematizohet në vendin e punës që ka qenë i pezulluar ose në një vend tjetër pune, që është i përshtatshëm me nivelin e përgatitjes së tij profesionale.

Neni 13

(1) Për drejtor të Orkestrës së Muzikës Xhaz mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin e Kulturës.

(2) Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin e Kulturës, për drejtor të Orkestrës së Muzikës Xhaz mund të zgjidhet personi që i plotëson edhe kushtet e veçanta vijues:

- të ketë fituar së paku 240 kredi sipas SETK-së ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 të arsimit të lartë nga fusha shkencore e shkencave shoqërore ose nga fusha shkencore e shkencave humanitare.

Neni 14

Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz është i detyruar çdo gjashtë muaj të dorëzojë raport tek ministri i Kulturës dhe i Turizmit, në mënyrën e përcaktuar me Ligjin e Kulturës.

Neni 15

Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz, nëse konstaton parregullsi në punën e orkestrës, është i detyruar të ndërmarrë masa për eliminimin e atyre parregullsive, ndërsa sipas nevojës mund të formojë edhe komision profesional për shqyrtimin e një rasti të caktuar.

Neni 16

Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz, mund të shkarkohet edhe para përfundimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, në rastet e përcaktuara me ligj.

Neni 17

(1) Në rast se nuk është zgjedhur drejtor ose mandati i tij ka përfunduar para kohe, ministri i Kulturës dhe i Turizmit menjëherë emëron ushtrues detyre drejtor të Orkestrës së Muzikës Xhaz, pa shpallje të konkursit publik, nga radhët e të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz.

(2) Ushtruesi i detyrës i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz. Ushtruesi i detyrës drejtor emërohet për periudhën deri në zgjedhjen e drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Organ i menaxhimit

Këshilli drejtues

Neni 18

(1) Organ i menaxhimit i Orkestrës së Muzikës Xhaz është Këshilli drejtues.

(2) Këshillin drejtues të Orkestrës së Muzikës Xhaz e përbëjnë pesë përfaqësues, të cilët i emëron dhe i shkarkon ministri i Kulturës dhe i Turizmit, nga të cilët dy janë përfaqësues nga radhët e individëve të shquar në fushën e kulturës, një është nga vetëqeverisja lokale dhe dy janë përfaqësues nga të punësuarit e Orkestrës së Muzikës Xhaz. Në institucion me më pak se dhjetë të punësuar, në Këshillin drejtues emërohet një anëtar nga të punësuarit, një nga vetëqeverisja lokale dhe tre anëtarë nga radhët e individëve të shquar në fushën e kulturës. Përfaqësuesin e vetëqeverisjes lokale në Këshillin drejtues e propozon kryetari i komunës së njësisë së vetëqeverisjes lokale ku ndodhet selia e institucionit.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit drejtues të Orkestrës së Muzikës Xhaz emërohen mbi parimin e profesionalizmit dhe kompetencës, për një periudhë katërvjeçare dhe mund të emërohen përsëri.

(4) Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit drejtues të Orkestrës së Muzikës Xhaz u takon shpërblim financiar i përshtatshëm, të cilin e përcakton ministri i Kulturës dhe i Turizmit.

Neni 19

(1) Kryetari i Këshillit drejtues i thërret mbledhjet, propozon rendin e ditës dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit drejtues.

(2) Në mungesë të arsyetuar të kryetarit të Këshillit drejtues, mbledhjet do t'i thërrasë, do ta propozojë rendin e ditës dhe do t'i udhëheqë mbledhjet e Këshillit drejtues personi i caktuar nga vetë Këshilli drejtues, në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me rregulloren e punës së Këshillit drejtues.

(3) Këshilli drejtues mund të funksionojë dhe të marrë vendime vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

(4) Vendimet e Këshillit drejtues konsiderohen të miratuara nëse për to kanë votuar më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Këshillit drejtues.

(5) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit drejtues janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit drejtues.

(6) Për punën e tij, Këshilli drejtues është përgjegjës para ministrit të Kulturës dhe Turizmit.

(7) Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz ka të drejtë dhe detyrim të marrë pjesë në punën e Këshillit drejtues, në përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit drejtues, të tregojë për ligjshmërinë dhe vendimmarrjen e Këshillit drejtues, pa të drejtë vendimmarrjeje.

(8) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit drejtues të Orkestrës së Muzikës Xhaz, nuk mund të kenë interesa personale, nëpërmjet personit të tretë ose mbi çfarëdo baze tjetër, në

Orkestrën e Muzikës Xhaz, të cilat mund të kenë çfarëdo ndikim mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre në menaxhimin e Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(9) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit drejtues të IN "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" — Shkup janë të detyruar ta njoftojnë themeluesin për ekzistencën e një interesi të tillë.

Neni 20

Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz:

1. Miraton statutin;
2. Përcakton politikat dhe parimet për zhvillimin dhe punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz;
3. Jep pëlqimin për projekt-programin vjetor të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz, me propozim të drejtorit;
4. Miraton raportin vjetor për punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz, me propozim të drejtorit;
5. Jep pëlqimin për aktin e organizimit të brendshëm dhe për sistematizimin e vendeve të punës të Orkestrës së Muzikës Xhaz;
6. Miraton dokumentet për veprimtarinë financiare të Orkestrës së Muzikës Xhaz, në pajtim me dispozitat për veprimtarinë materiale dhe financiare;
7. Vendos në shkallën e dytë për aktvendimet e miratuara nga drejtori;
8. Jep propozim të arsyetuar ministrit të Kulturës dhe të Turizmit për shkarkimin e drejtorit;
9. Miraton rregulloren e punës së tij;
10. Ndjek realizimin e programit vjetor të punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz;
11. Miraton rregulloren për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe të aplikimit për punësim, mënyrën e zhvillimit të revizionit, si dhe mënyrën e pikëzimit në varësi të kategorisë dhe nivelit të vendit të punës për të cilin është publikuar konkursi publik, me propozim të drejtori;
12. Miraton rregulloren për formën dhe përmbajtjen e konkursit të brendshëm, si dhe të aplikimit për avancim, mënyrën e zhvillimit të përzgjedhjes për avancim, mënyrën e zhvillimit të revizionit, si dhe mënyrën e pikëzimit të tyre, me propozim të drejtorit;
13. Miraton rregulloren për kriteret e detajuara për zhvillimin e vlerësimit të ofruesve të shërbimeve publike në kulturë, për masën e shpërblimit financiar ose të llojit tjetër material ose jomaterial, për uljen e pagës ose sistemimin në vend pune të nivelit më të ulët, me propozim të drejtorit;
14. Një herë në vit dorëzon raport për punën e tij në Ministrinë e Kulturës dhe të Turizmit dhe
15. Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Neni 21

(1) Mandati i kryetarit ose i një anëtari të Këshillit drejtues mund të përfundojë, nëse:
1. ka paraqitur dorëheqje;

2. është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, me të cilin është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajsh;

3. tek ai ka ndodhur paaftësi e përhershme ose e përkohshme për ushtrimin e pandërprerë të funksionit më gjatë se gjashtë muaj.

(2) Kryetari ose anëtari i Këshillit drejtues mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit nëse:

1 . vepron në kundërshtim me ligjin dhe këtë statut

2. konstatohet se për fajin e tij Orkestra e Muzikës Xhaz nuk e realizon veprimtarinë e saj;

3 mungon pa arsye tri herë radhazi nga mbledhjet e Këshillit drejtues ose nuk e ushtron detyrën më gjatë se gjashtë muaj;

4. konstatohet se ka interesa personale, përmes personi të tretë ose mbi çfarëdo baze tjetër, që mund të ndikojnë mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në punën e Këshillit drejtues, pra konflikt interesi;

5. nuk merr pjesë në vendimmarrjen për çështje nga kompetenca e Këshillit drejtues të paktën tri herë brenda një viti.

(3) Kryetari ose anëtari i Këshillit drejtues mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit edhe me propozim të arsyetuar nga ai që e ka propozuar.

Neni 22

Këshilli drejtues miraton rregulloren për punën dhe vendimmarrjen e tij..

a. Trupat profesionale

Këshilli artistik

Neni 23

(1) Për shqyrtimin e çështjeve të caktuara me karakter profesional, drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz mund, me aktvendim, të formojë Këshillin artistik.

(2) Me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet përbërja dhe fushëveprimi i punës së Këshillit artistik.

(3) Me mbledhjet e Këshillit artistik kryeson drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(4) Këshilli artistik i Orkestrës së Muzikës Xhaz ushtron këto detyra:

1 . zhvillon, zbaton dhe vlerëson programet vjetore dhe mujore;

2. merr pjesë në zhvillimin e buxhetit të Orkestrës së Muzikës Xhaz, i cili hartohet nga drejtori i institucionit;

3. jep propozime për ndërtimin e marrëdhënieve me organizata të tjera kulturore dhe partnerë të Orkestrës së Muzikës Xhaz;

4. Merr pjesë në përgatitjen, organizimin dhe realizimin e programeve koncertale në përputhje me planin e punës të Orkestrës së Muzikës Xhaz;

5. Zhvillon programet muzikore tematike,

6. Merr pjesë në dizajnimin e kostumeve dhe rekuizitave;

7. Kryen edhe punë të tjera të lidhura me programin e Orkestrës së Muzikës Xhaz.

Neni 24

(1) Sipas nevojës, drejtori mund të formojë edhe komisione të tjera profesionale dhe këshillëdhënëse, si dhe trupa pune.

(2) Numri i anëtarëve, kompetencat, kohëzgjatja, detyrat, mandati dhe fushëveprimi i punës së komisioneve dhe trupave të punës përcaktohen me aktin për formimin e tyre.

(3) Për anëtar të komisioneve ose trupave të punës, i njëjti person mund të zgjidhet disa herë.

(4) Komisionet ose trupat e punës, për veprimtarinë e tyre, i përgjigjen drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe janë të detyruar t'i paraqesin raport për punën e kryer.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 25

Të drejtat, detyrat dhe çështjet e tjera nga fusha e marrëdhënieve të munës së të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz rregullohen nga dispozitat e Ligjit të Kulturës dhe nga aktet për Administratën Publike, aktet për Marrëdhëniet e Punës dhe Marrëveshjet Kolektive të lidhura në pajtim me ligjin.

MARRËVESHJE KOLEKTIVE

Neni 26

Çështjet nga fusha e Marrëdhënieve të Punës së të Punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz rregullohen më tej me marrëveshje kolektive në nivel të punëdhënësit, në pajtim me ligjin dhe me Marrëveshjen Kolektive për Kulturën.

III. Akte të përgjithshme

Akte të tjera të përgjithshme

Neni 27

(1) Çështje të caktuara nga veprimtaria e Orkestrës së Muzikës Xhaz rregullohen më hollësisht me rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme, në pajtim me ligjin dhe këtë statut.

(2) Në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni, në Orkestrën e Muzikës Xhaz miratohen veçanërisht:

1. Rregullore për organizimin e brendshëm dhe Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës;

2. Plani vjetor i punësimit, në pajtim me ligjin;

3. Rregullore për formën dhe përmbajtjen e konkursit publik dhe të aplikimit për punësim, mënyrën e zhvillimit të revizionit, si dhe mënyrën e pikëzimit në varësi të kategorisë dhe nivelit të vendit të punës për të cilin është shpallur konkursi publik;

4. Rregullore për formën dhe përmbajtjen e konkursit të brendshëm, si dhe të aplikimit për avancim, mënyrën e zhvillimit të përzgjedhjes për avancim, mënyrën e zhvillimit të revizionit, si dhe mënyrën e pikëzimit të tyre;

5. Rregullore për kriteret e detajuara për zhvillimin e vlerësimit të ofruesve të shërbimeve publike në kulturë, sipas nenit 77-i paragrafi (2) të Ligjit të Kulturës, për masën e shpërblimit financiar ose të llojit tjetër material ose jomaterial, për uljen e pagës ose sistemimin në vend pune të nivelit më të ulët;

6. Rregullore për mbrojtjen në punë;

7. Rregullore për mbrojtjen nga zjarri;

8. Rregullore për përmirësimin profesional;

9. Rregullore për veprimtarinë botuese;

10. Rregullore për punën e Këshillit drejtues;

1 1 . Rregullore për punën e Këshillit artistik;

12. Akte për ruajtjen, përpunimin dhe përdorimin e dokumentacionit dhe

1 3. Akte të tjera që dalin nga ky statut ose nga ligji.

(3) Akte të Orkestrës së Muzikës Xhaz duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me këtë statut.

Neni 28

(1) Orkestra e Muzikës Xhaz është e detyruar që në ueb-faqen e saj zyrtare të publikojë projektet që realizohen gjatë vitit aktual.

(2) Orkestra e Muzikës Xhaz, në tremujorin e parë të vitit aktual, për vitin e kaluar, dorëzon raport në Ministrinë e Kulturës dhe të Turizmit për realizimin e programit vjetor të punës, i cili përmban paraqitje narrative për realizimin e programit, specifikim për mjetet e shpenzuara gjithsej, kontrata, llogari, fatura dhe plan financiar përfundimtar me të gjitha shumat e mjeteve të shpenzuara dhe burimet e financimit.

(3) Orkestra e Muzikës Xhaz, në uebfaqen e saj zyrtare, në tremujorin e parë të vitit aktual për vitin e kaluar, publikon raportin për realizimin e programit vjetor të punës.

Neni 29

Statuti i Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe aktet e tjera të përgjithshme që i miraton Këshilli drejtues miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Neni 30

(1) Iniciativë për miratimin e një statuti të ri ose për ndryshime dhe plotësime të tij mund të paraqesë:

1. Të paktën një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit drejtues të Orkestrës së Muzikës Xhaz,
2. Drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz, dhe
3. Organ tjetër shtetëror kompetent.

(2) Iniciativa nga paragrafi (1) i këtij neni, në formë të shkruar, dorëzohet te Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(3) Këshilli drejtues është i detyruar ta shqyrtojë iniciativën dhe mbi të të marrë vendim të përshtatshëm.

(4) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni i dorëzohet paraqitësit të iniciativës.

Neni 31

Ndryshimi dhe plotësimi i statutit dhe i akteve të tjera të përgjithshme kryhet sipas të njëjtës procedurë si për miratimin e tyre.

Neni 32

Të gjitha aktet e përgjithshme që miratohen në Orkestrën e Muzikës Xhaz publikohen detyrimisht në tabelën e saj të shpalljeve dhe hyjnë në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes së tyre.

VII. INFORMACIONE TË KLASIFIKUARA, ÇËSHTJE TË LIDHURA ME MBROJTJEN, GJENDJE LUFTE DHE TË JASHTËZAKONSHME DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Informacion i klasifikuar

Neni 33

(1) Informacion i klasifikuar është informacioni që mbrohet nga qasja ose përdorimi i paautorizuar dhe që përcaktohet me shkallë klasifikimi në pajtim me ligjin.

(2) Për informacione të klasifikuara konsiderohen dokumentet dhe të dhënat të cilat: - organi kompetent i ka shpallur ato informacione të klasifikuara; një organ kompetent i shpalli ato konfidenciale dhe ia komunikoi Orkestrës së Xhazit; në lidhje me mbrojtjen, ato janë shënuar si informacione të klasifikuara.

(3) Informacion të klasifikuar përfaqësojnë edhe dokumentet që përcaktohen me aktet nënligjore dhe që Këshilli drejtues i ka shpallur si informacion të klasifikuar.

(4) Dokumentet dhe të dhënat që konsiderohen si informacion i klasifikuar janë të detyruar t'i ruajnë të gjithë punonjësit e Orkestrës së Muzikës Xhaz, gjatë kohës sa janë në marrëdhënie pune, si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, për një periudhë prej tre vitesh.

(5) Dokumentet dhe të dhënat që përfaqësojnë informacion të klasifikuar nuk mund të jepen për shqyrtim pa miratimin e drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz.

Neni 34

(1) Klasifikimi i informacioneve kryhet sipas përmbajtjes së tyre nga personi i autorizuar, në pajtim me dispozitat ligjore.
(2) Informacionet që nuk janë të destinuara për përdorim publik, dhe me zbulimin e të cilave do të zvogëlohej efikasiteti i punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz, marrin shenjën "për përdorim të kufizuar".

Neni 35

(1) Kriteret, masat dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe përdorimin e informacioneve të klasifikuara përcaktohen sipas ligjit dhe planit për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara për gjendjet e jashtëzakonshme.
(2) Orkestra e Muzikës Xhaz është e detyruar të krijojë kushte të domosdoshme për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe të ndërmarrë masa për eliminimin e pasojave negative, nëse ndodh zbulimi i informacioneve të klasifikuara.
(3) Për ekzekutimin efikas dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me informacione të klasifikuara në Orkestrën e Muzikës Xhaz, përcaktohen persona të autorizuar të cilët duhet të posedojnë certifikatë sigurie, e cila u lëshohet për shkallën përkatëse të informacionit të klasifikuar, sipas parimit "është e nevojshme të dihet".
(4) Dhënia e dokumenteve dhe të dhënave që janë shpallur si informacione të klasifikuara tek persona të tretë regjistrohet në një evidencë të veçantë, në të cilën shënohen: emri dhe mbiemri i personit dhe emri i organit të cilit i janë komunikuar të dhënat, respektivisht i janë dorëzuar dokumentet; lloji i të dhënave; forma në të cilën janë komunikuar; si dhe qëllimi dhe sipas kërkesës së kujt janë dhënë.
(5) Evidenca nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohet konfidenciale dhe ruhet në një vend të veçantë të sigurt, në ambientet e Orkestrës së Muzikës Xhaz.

Çështjet që lidhen me mbrojtjen

Neni 36

(1) Informacion të klasifikuar përfaqësojnë të dhënat në dokumentet me rëndësi për mbrojtjen.
(2) Në dokumentet që përfaqësojnë informacion të klasifikuar, varësisht nga rëndësia e tyre, në këndin e sipërm të djathtë vendoset fjala "Mbrojtje", dhe poshtë saj caktohet një nga tre shkallët e fshehtësisë: "Tepër konfidenciale", "Konfidenciale" ose "E brendshme".

Neni 37

Orkestra e Muzikës Xhaz përgatit dokumente, organizon dhe zbaton përgatitje për mbrojtje, siguri, shpëtim dhe menaxhim të krizave sipas ligjit.

Neni 38

Orkestra e Muzikës Xhaz, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe të Turizmit, kryen financimin e përgatitjeve për mbrojtje, siguri, shpëtim dhe menaxhim të krizave.

Neni 39

Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Orkestra e Muzikës Xhaz është e detyruar të kryejë shërbime që kanë rëndësi të veçantë për mbrojtjen.

Gjendja e luftës dhe e jashtëzakonshme

Neni 40

Në gjendje lufte ose të jashtëzakonshme, Orkestra e Muzikës Xhaz ndërmerr masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e të punësuarve dhe përdoruesve të shërbimeve që ndodhen në ambientet e institucionit dhe objektet e saj, si dhe zbatimin e masave të veçanta për mbrojtjen e të mirave materiale dhe dokumenteve, materialeve dhe të dhënave që përfaqësojnë informacion të klasifikuar dhe sekret tjetër.

(1) Të punësuarit janë të detyruar, në rast të konflikteve ushtarake ose në rast të gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve të tjera, të kujdesen për pasurinë e Orkestrës së Muzikës Xhaz. Detyrat dhe obligimet e të punësuarve në këto kushte përcaktohen sipas ligjit.

Neni 41

Në pjesën e mbrojtjes në Orkestrën e Muzikës Xhaz, nuk hartohen akte të veçanta të përgjithshme por zbatohen drejtpërdrejt dispozitat ligjore dhe nënligjore për këtë fushë.

Mbrojtja e të dhënave personale

Neni 42

(1) Gjatë kryerjes së detyrave të punës, Orkestra e Muzikës Xhaz ka nevojë për përdorimin e të dhënave personale të të punësuarve të Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe vizitorëve të Orkestrës së Muzikës Xhaz, të cilat përdoren në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(2) Të dhënat personale për të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz mblidhen, përpunohen dhe dorëzohen tek persona të tretë në pajtim me ligjin, për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës ose në lidhje me marrëdhënien e punës.

(3) Të dhënat personale për personat e jashtëm në Orkestrën e Muzikës Xhaz mblidhen, përpunohen, përdoren dhe sipas nevojës, dorëzohen tek organet kompetente, me qëllim mbrojtjen e pronës, trashëgimisë kulturore dhe vlerave të tjera materiale që ndodhen në Orkestrën e Muzikës Xhaz.

Neni 43

Të dhënat personale për të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz dhe për personat e jashtëm mund të mblidhen, përpunohen, përdoren dhe dorëzohen tek persona të tretë vetëm nga drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe/ose nga persona të autorizuar prej tij.

Neni 44

Mbrojtja e të dhënave personale realizohet në pajtim me dispozitat ligjore, aktet nënligjore dhe aktet e përgjithshme të Orkestrës së Muzikës Xhaz.

EVIDENCA

Neni 45

(1) Orkestra e Xhazit është e detyruar të mbajë të dhëna në pajtim me rregulloret për punë zyre dhe arkivore, si më poshtë vijon:

- librat e dorëzimit të brendshëm, librat e dërgimit për postën, librin e pranimit për postën; - të mbajë dhe ruajë dosjet e punonjësve;
- të mbajë dhe të ruajë të dhënat e shfaqjeve muzikore, skenike dhe koncertale;

të mbajë përmbledhje dhe koleksione të shkrimeve për çmimet e fituara nga Orkestra e Muzikës Xhaz dhe nga individët; ـ të mbajë evidencë të shkrimeve kritike, recensioneve dhe shënimeve për premierat, si dhe të përmbledhë programet e punës dhe vjetarëve të aktivitetit;

- të mbajë dhe të ruajë skicat dhe maketet skenografike-kostumografike, plakatotekën dhe fototekën.

(2) Orkestra e Muzikës Xhaz mund të mbajë edhe lloj tjetër të evidencës dhe dokumentacionit, në pajtim me dispozitat ligjore, këtë statut dhe aktet e Orkestrës së Muzikës Xhaz.

FINANCIMI

Burimet e mjeteve

Neni 46

(1) Mjetet për punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz sigurohen nga:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrën dhe në procedurën e përcaktuar me Ligjin e Kulturës dhe Dispozitat për Financimin Buxhetor;
- Të ardhurat e veta nga kryerja e shërbimeve brenda juridiksionit të saj;
- Donacione nga Organizata Ndërkombëtare ose nga persona juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj dhe
- Sponsorizime, donacione, testamentet dhe burime të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Të ardhurat vetjake në kuptim të paragrafit (1) nënparagrafi 2 të këtij neni sigurohen nga:

- Biletat;
- Librat, publikimet dhe të ngjashme;
- Të ardhura nga shërbimet;
- Të ardhura nga lloje të tjera të aktiviteteve kontraktuale.

(3) Lartësia e çmimit të shërbimeve në kuptim të paragrafit (2) të këtij neni e përcakton Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz me vendim ose rregullore, me të cilën përcaktohet lloji i shërbimit dhe kompensimi për kryerjen e tij (çmimorja).

INFORMIMI

Njoftimi i të punësuarve

Neni 47

(1) Njoftimi i të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz bëhet në mënyrë të qasshme për çdo punëtor.

(2) Njoftimi në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni bëhet detyrimisht nëpërmjet tabelës së shpalljeve dhe drejtpërdrejt nga punonjësit udhëheqës.

(3) Në tabelën e shpalljeve detyrimisht publikohen aktet e përgjithshme të Orkestrës së Muzikës Xhaz, aktet e veçanta të Këshillit drejtues dhe të drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz, njoftimet dhe aktet e tjera të shkruara.

(4) Drejtori dhe punonjësit udhëheqës janë të obliguar të informojnë rregullisht të punësuarit për punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe për rezultatet e arritura, për gjendjet aktuale dhe çështjet e hapura, aktivitetet e ardhshme dhe të ngjashme, që janë me interes për të punësuarit.

(5) Me kërkesë, çdo i punësuar mund të realizojë qasje në dokumentacionin zyrtar me miratimin e drejtorit të Orkestrës së Muzikës Xhaz, me përjashtim të dokumenteve që paraqesin informacione të klasifikuara, të dhëna personale të mbrojtura ose janë të shënuara me lloj dhe shkallë tjetër të fshehtësisë në pajtim me ligjin.

Njoftimi i publikut

Neni 48

(1) Puna e Orkestrës së Muzikës Xhaz është publike.

(2) Orkestra e Muzikës Xhaz e njofton opinionin publik për punën e saj nëpërmjet mjeteve të informimit publik dhe në pajtim me dispozitat për qasje të lirë në informata me karakter publik.

(3) Njoftimi në kuptim të paragrafit (2) të këtij neni bëhet nëpërmjet njoftimeve të veçanta, shpalljeve të paguara, shkrimeve, bisedave, pjesëmarrjes në emisione speciale të mediave elektronike dhe të ngjashme.

(4) Njoftimi i opinionit publik bëhet edhe nëpërmjet një ose më shumë ueb-faqeve të Orkestrës së Muzikës Xhaz.

(5) Personi përgjegjës për dhënien e informacioneve për opinionin publik është drejtori i Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe/ose PERSONI që ai do ta autorizojë në pajtim me dispozitat për qasje të lirë në informata me karakter publik.

Neni 49

(1) Opinionit publik në punën e Orkestrës së Muzikës Xhaz i sigurohet edhe nëpërmjet publikimit në mjetet e informimit publik ose në internet të të dhënave vijuese:

- emri dhe adresa e Orkestrës së Muzikës Xhaz; lloji i veprimtarisë që e kryen Orkestra e Muzikës Xhaz; orari i punës së Orkestrës së Muzikës Xhaz; çmimorja e shërbimeve dhe logoja, përkatësisht shenja e mbrojtur e Orkestrës së Muzikës Xhaz.

DISPOZITAT E VEÇANTA

Orari i punës

Neni 50

(1) Orarin e punës të Orkestrës së Muzikës Xhaz e përcakton Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz me vendim, nëse me ligj ose me Marrëveshje kolektive nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Në raste të arsyetuara, sipas nevojës, Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz mund me vendim të veçantë të përcaktojë orar tjetër pune për projekte të veçanta, programe, shfaqje, KONCERTE ose aktivitete të tjera programore të Orkestrës së Muzikës Xhaz, të ndryshme nga orari i punës i përcaktuar në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni.

Greva

Neni 51

Të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz kanë të drejtë për grevë të organizuar në pajtim me ligjin dhe me Marrëveshjen kolektive.

Pasuria e institucionit

Neni 52

(1) Orkestra e Muzikës Xhaz nuk disponon, as nuk përdor pasuri të paluajtshme që është në pronësi shtetërore.

(2) Për pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të Orkestrës së Muzikës Xhaz mbahet evidencë kontabël dhe ajo përdoret në pajtim me dispozitat për përdorimin dhe disponimin e sendeve në pronësi shtetërore.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Koordinimi i punës

Neni 53

Orkestra e Muzikës Xhaz do ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e këtij statuti brenda një muaji nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

Miratimi i akteve të përgjithshme

Neni 54

Akte të tjera të përgjithshme nga neni 27 paragrafi (2) i këtij statuti do të miratohen brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.

Shfuqizimi i statutit ekzistues

Neni 55

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij statuti pushon së vlefshmi Statuti i Institucionit Nacional “ORKESTRA E MUZIKËS XHAZ E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT” – Shkup nga 1.6.2023, si dhe f. 01-02 , datë 23.8.2023.

Hyrja në fuqi e këtij statuti

Neni 56

Ky statut hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të Orkestrës së Muzikës Xhaz, dhe do të publikohet menjëherë pas marrjes së pëlqimit nga ministri i Kulturës dhe i Turizmit.

11.04.2025,
Shkup.

Оркестар за џез музика